



Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)

Pasqyrat Financiare Vjetore dhe Raporti i Auditorit të pavarur

01 Janar 2023 - 31 Dhjetor 2023



Përmbajtja:

Raport i auditorëve të Pavarur..	3
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	7
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve.....	8
Informata të përgjithshme	9
Shënimet e pasqyrave financiare.....	10-15

Raport i Auditorëve të pavarur

Drejtuar Kryesisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës

Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

Opinion i kualifikuar

Ne kemi audituar raportet financiare bashkëngjitura të Subjektit Politik “Lidhja Demokratike e Kosovës” (në vijim referuar si “Subjekti Politik” apo “LDK”), te përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 Dhjetor 2023, Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve për periudhën e përfunduar me këtë datë, dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira ne fq. 6-14

Sipas mendimit tonë, me përjashtim të efekteve për çështjet e përshkruara në seksionin e Bazës për Opinionin të kualifikuar të raportit tonë, Pasqyrat Financiare të bashkëngjitura paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të subjektit Politik me datën 31 Dhjetor 2023, dhe të Hyrat dhe Shpenzimet për periudhën, në pajtim me Ligjin 08/L-122 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-212 dhe me ligjin Nr.04/L-058.

Bazat për Opinion te kualifikuar

- Gjate auditimit ton ne kemi konstatuar qe subjekti politik LDK për zyrat e saja në selinë qendrore nuk ka prezantuar asnjë kontrate për shfrytëzimin e lokaleve me qira dhe njëkohësisht nuk ka prezantuar flete poseduese te objektit, përkundër qe SP ka deklaruar dhe paguar tatim ne pronë për objektin ne vlere 1,437 EURO për vitin qe përfundon me 31 Dhjetor 2023.

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në Përgjegjësitë e Auditorit ne paragrafin për Auditimin e Pasqyrave Financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Subjekti politik në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistet Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistet Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit IESBA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

Theksim i çështjes

Pa e kualifikuar me tej opinionin ton ne tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme:

- Subjekti Politik ne blerjet e kryera nuk ka aplikuar ndonjë procedure te tenderimit e cila do te mundësonte një shfrytëzim sa më efikas, me kosto ekonomike, transparente dhe të drejtë të fondeve të subjektit politik.

- Subjekti Politik edhe pse e ka te definuar me Statut, (neni 36 i statutit) ,mundësinë e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financiar të saj dhe të drejtën e anëtarëve për t'u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjekteve politike si dhe për përgjegjësinë e organit gjegjës për transaksione financiare, ashtu siç parashihet ne ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 17 Kontrolli i Brendshëm. Komisioni mbikëqyrës si trup kontrollues nuk ka bere kontrollin e brendshëm si dhe nuk na ka ofruar një raport për punën e bere.
- Për periudhën raportuese SP kishte ma shumë se një llogari bankare aktive

Çështje tjera

- Pasqyrat financiare të subjektit politik për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2022 janë audituar nga auditor tjetër opinionin i të cilëve mbi këto pasqyra ka qen i kualifikuar për llogarite e pagueshme, pronësinë e objekteve dhe shpenzimet e qirasë.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre te ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin 08/L-122 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-212 dhe me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj(parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, te çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës se kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë. Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe

marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.

- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit & Conto sh.p.k

Mexhid Aliu
Auditor Ligjor
21 Qershor 2024

Pasqyra e Pozitës Financiare

Pasuritë		Me 31 Dhjetor 2023	Me 31 Dhjetor 2022
Pasuritë afatgjata	Shënimi	Shuma në Euro	Shuma në Euro
Toka, objektet dhe pajisjet	5	27,459.34	36,781.34
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë tjera afatgjata			
Total pasuritë afatgjata		27,459.34	36,781.34
Pasuritë afatshkurtra			
Llogaritë e arkëtueshme	6	0.00	0.00
Parapagimet			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	3	10,968.65	708.98
Pasuritë tjera afatshkurtra			
Total pasuritë afatshkurtra		10,968.65	708.98
Total pasuritë		38,427.99	37,490.32
Ekuiteti			
Fondet e akumuluar		(563,870.58)	(630,152.77)
Suficiti / (deficiti) i vitit		291,345.54	66,282.19
Total Ekuiteti		(272,525.04)	(563,870.58)
Detyrimet			
Detyrimet afatgjata			
Huatë e pagueshme		27,276.39	32,986.36
Të hyrat e shtyera	5	27,459.34	36,781.34
Gjithsej detyrimet afatgjata		54,735.73	69,767.70
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	8	183,671.76	466,397.14
Huatë e pagueshme			
Detyrimet tjera afatshkurtra	9	72,545.54	65,196.06
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		256,217.30	531,593.20
Gjithsej detyrimet		310,953.03	601,360.90
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		38,427.99	37,490.32

Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve

	Shënimi	Viti që përfundon me 31 Dhjetor	
		2023	2022
Të hyrat			
Të hyrat nga buxheti		525,000.00	487,140.00
Të hyrat nga anëtarësia			
Donacionet dhe kontributet në të holla	3	39,483.00	1,000.00
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime	4		
Të hyrat e fushatës			
Te hyrat e liruar nga te hyrat e shtyera	5	9,322.00	9,195.33
Të hyrat tjera		149,364.92	78.68
Gjithsej të hyrat për vitin		723,169.92	497,414.01
Shpenzimet			
Pagat dhe kompensimet	2	276,504.88	280,288.53
Shpenzimet e transportit	2	22,704.41	24,442.52
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	2	64,856.72	31,828.31
Shpenzimet e fushatës	2	0.00	
Blerja e mallrave	2	3,935.20	3,844.37
Shpenzimet e përgjithshme	2	62,097.48	75,046.38
Shpenzimet e ndryshme	2	1,725.69	15,681.71
Gjithsej shpenzimet për vitin		431,824.38	431,131.82
Suficiti / (deficiti) për vitin		291,345.54	66,282.19

1. Informata te përgjithshme

Lidhja Demokratike e Kosovës është themeluar më 28-Dhjetor të vitit 1989.

Kryetari i lidhjes Demokratike të Kosovës është z. Lumir Abdixhiku

Zyrtar financiar : z. Arton Retkoceri

Pasqyrat financiare te Lidhjes Demokratike te Kosovës janë përgatitur sipas kërkesave te Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar.

Bazuar në nenin 19 paragrafi 10 te Ligjit 08/L-122 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-212 dhe me ligjin Nr.04/L-058, Subjekti i regjistruar politik brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të punës nga marrja e draft raporteve të audituara ka dorëzuar raportin e rishikuar financiar dhe shpjegimet lidhur me gabimet ose lëshimet të identifikuar nga auditorët.

Subjekti politik për periudhën raportuese ka me shumë se një llogari bankare aktive.

Shënimi 2. Shpenzimet

Shpenzimet	Shpenzimi në Euro	Pagesa në Euro	Borxhi i mbetur në Euro
Pagat dhe kompensimet			
Pagat dhe kompensimet, neto	238,288.64	238,288.64	0.00
Kontributet pensionale të punëmarrësit	12,828.77	11,705.17	1,123.60
Kontributet pensionale të punëdhënësit	12,828.77	11,705.17	1,123.60
Tatimet në të ardhura personale	12,558.70	11,402.69	1,156.01
Beneficionet tjera			0.00
Gjithsej	276,504.88	273,101.67	3,403.21
Shpenzimet e transportit			
Automjetet motorike të huazuara			0.00
Karburantet	15,441.82	13,861.09	1,580.73
Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksit etj.	1,716.48	1,603.48	113.00
Sigurimi dhe mirëmbajtja e veturave	5,546.11	3,653.78	1,892.33
Çdo shpenzim tjetër i transportit			0.00
Gjithsej shpenzimet e transportit	22,704.41	19,118.35	3,586.06
Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat			
Lokali			0.00
Ushqimi	25,886.24	7,508.22	18,378.02
Aktivitete kulturore dhe rekreative			0.00
Radio dhe spotet televizive			0.00
Stendat e afishmit dhe reklamimet në gazeta			0.00
Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave	38,970.48	29,659.38	9,311.10
Gjithsej reklammat, reprezentacioni dhe konferencat	64,856.72	37,167.60	27,689.12
Shpenzimet e fushatës			

Lidhja Demokratike e Kosovës

Shënimet për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2023 deri më 31 Dhjetor, 2023

Shpenzimet e fushatës			
Gjithsej shpenzimet e fushatës			
Blerja e mallrave			
Furnizimi i zyrës	3,935.20	3,086.22	848.98
Pajisjet të vogla			0.00
Gjithsej blerja e mallrave	3,935.20	3,086.22	848.98
Shpenzimet e përgjithshme			
Qiraja e lokalit të zyrës	44,271.09	2,339.34	41,931.75
Telefoni, interneti dhe posta	2,669.22	2,619.22	50.00
Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)	5,835.17	2,439.38	3,395.79
Shpenzimet e zhvlerësimit të pasurisë afatgjatë	9,322.00	////////////////////	////////////////////
Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet në natyrë në mallra dhe shërbime		////////////////////	////////////////////
Gjithsej shpenzimet e përgjithshme	62,097.48	7,397.94	45,377.54
Shpenzimet e ndryshme			
Mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës			0.00
Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër	1,725.69	1,725.69	0.00
Gjithsej shpenzimet e ndryshme	1,725.69	1,725.69	0.00
Gjithsej shpenzimet	431,824.38	341,597.47	80,904.91

Shënimi 3: Donacionet dhe kontributet në të holla

Pranuar nga			Data kur është dhënë kontributi	Vlera në euro	E pranuar përmes:	
Kontribuesi	Adresa	Numri personal			Bankë	Arkë
LULZIM MALIQI			15.06.2023	985.00	PO	
ANDRIT TAHIR	Vushtrri		09.08.2023	800.00	PO	
MAJLINDA SAHITI			10.08.2023	598.00	PO	
PREND ZEFI			11.08.2023	600.00	PO	
CENE BEHRAMI	Skenderaj		16.08.2023	550.00	PO	
EGZON QORRI	Drenas		16.08.2023	550.00	PO	
KALTRINA ZHERKA			18.08.2023	300.00	PO	
MERITON SHALA			28.08.2023	700.00	PO	
JON BYTYQI	Gjakove		11.09.2023	1,000.00	PO	
LUMIR ABDIXHIKU	Prishtinë		13.09.2023	1,900.00	PO	
XHAFER SHAHIN TAHIRI	Vushtrri		15.09.2023	2,000.00	PO	
DOARSA KICA XHELILI	Prishtine		18.09.2023	1,200.00	PO	
JEHONA LUSHAKU	Prishtinë		20.09.2023	1,200.00	PO	
BESIAN MUSTAFA	Prishtine		20.09.2023	2,000.00	PO	
KRENAR XHAFERI	Rr.Arberi Prishtine		22.09.2023	1,600.00	PO	
FLAMUR ISTREFI			25.09.2023	2,000.00	PO	
ALBAN ZOGAJ	Prishtine		25.09.2023	1,000.00	PO	
FLORIAN DUSHI	Prishtine		26.09.2023	1,000.00	PO	
ARSIM SELMONMUSAJ			28.09.2023	1,500.00	PO	

Lidhja Demokratike e Kosovës

Shënimet për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2023 deri më 31 Dhjetor, 2023

ARTON RETKOCERI	Prishtine		29.09.2023	2,000.00	PO	
SYLE BALAJ			04.10.2023	1,900.00	PO	
BERAT RUKIQI	Prishtine		05.10.2023	2,000.00	PO	
ATDHE BERISHA	Peje		05.10.2023	1,100.00	PO	
LAURETA ISUFI			13.10.2023	1,000.00	PO	
VALON IBRAHIMAJ			16.10.2023	1,000.00	PO	
VISAR DACI			16.10.2023	1,500.00	PO	
VETON ELSHANI			17.10.2023	1,500.00	PO	
ARBEN SALIH DACI			18.10.2023	1,000.00	PO	
DONAT MALIQ	Prishtine		20.10.2023	1,000.00	PO	
SKENDER DACIC			26.10.2023	1,000.00	PO	
ERJON ZOGAJ			30.10.2023	1,000.00	PO	
VALENTINA ISA BUNJAK			21.11.2023	2,000.00	PO	
Gjithsej donacionet dhe kontributet në të holla				39,483.00	-	////////////////////

Shënimi 4: Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime

Përshkrimi i mallit / shërbimit	Pranuar nga			Data kur është dhënë kontributi	Vlera në euro
	Kontribuesi	Adresa	Numri personal		
Gjithsej kontributet në natyrë në mall dhe shërbime					////////////////////

Shënimi 5: Toka, objektet dhe pajisjet

	Bilanci në fillim të vitit (kosto historike)	Blerjet gjatë vitit	Zhvlerësimi i akumuluar	Zhvlerësimi i vitit	Bilanci në fundë të vitit (vlera neto)
Toka					0.00
Objektet					0.00
Veturat	38,060.00	0.00	7,612.00	7,612.00	22,836.00
Pajisjet e zyrës	8,550.50	0.00	2,217.16	1,710.00	4,623.34
Pajisjet e teknologjisë informative					
Pajisjet tjera					
Gjithsej toka, objektet dhe pajisjet	46,610.50	0.00	9,829.16	9,322.00	27,459.34

Shënime tjera

Shënimi 6. Llogari të arkëtueshme	Me 31 Dhjetor 2023 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2022 Shuma në Euro
-		
-		
Gjithsej Llogarit e arkëtueshme		

Shënimi 7. Paraja dhe ekuivalentët e parasë	Me 31 Dhjetor 2023 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2022 Shuma në Euro
Paraja në bankë	408.98	9,205.82
Paraja në arkë	300.00	1,762.83
Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë	708.98	10,968.65

Shënimi 8. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	Me 31 Dhjetor 2023 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2022 Shuma në Euro
Furnitori 1 - regjistri	466,397.14	183,671.76

Lidhja Demokratike e Kosovës

Shënimet për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2023 deri më 31 Dhjetor, 2023

Furnitori 1		
Furnitori 1		
Gjithsej llogaritë e pagueshme dhe të tjera	466,397.14	183,671.76

Shënimi 9. Detyrimet tjera afatshkurtra	Me 31 Dhjetor 2023 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2022 Shuma në Euro
Detyrimet për paga dhe tatime	24,383.74	3,403.21
Detyrimet për qira	38,707.03	69,142.33
Detyrimet për gjoba dhe ndëshkime		
Detyrime tjera afatshkurtër (huazimet)	2,105.29	
Gjithsej detyrimet tjera afatshkurtra	65,196.06	72,545.54

Shënimi 10: Pagesat mbi 5,000.00 Euro

Qëllimi i pagesës	Paguar ndaj:			Data kur është bërë pagesa	Vlera në euro
	Përsoni Fizik/Juridik	Adresa	Numri personal		
Marketing	METTON REKLAMA SH.P.K.	Podujevë			11,229.38
Nafta	IP - KOS SH.P.K.	Prishtinë			10,920.13
Qira për Zyre	Rrahman Hamiti - Podujeve	Podujevë			7,912.09
Organizim evente	AMC CORPORATION SH.P.K.	Prishtinë			5,900.00
Ushqim dhe Pije	BRUNI SH.P.K.	Prishtinë			5,179.00
Gjithsej pagesat mbi 5,000.00 Euro					41,140.60